



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. ____ Prot.
___.__.2021

Tiranë, më

VENDIM
Nr. 242, datë 09.06.2021

PËR
VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT {...}, ME QËLLIM
GRADIMI, PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 2013-2016

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i hartuar nga relatore znj. Brunilda Kadi,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi, të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR
KOMISIONI I VLERËSIMIT TË ETIKËS DHE
VEPRIMTARISË PROFESIONALE

RAPORT

VLERËSIMI ETIK DHE PROFESIONAL ME QËLLIM
PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË VLERËSIMIT (GRADIMIN) E
GJYQTARIT {...}

POLI I DREJTËSISË
RRUGA "ANA KOMNENA"
TIRANË

VLERËSIMI DHE PIKËZIMI PËR AFTËSITË E GJYQTARES SIPAS KRITEREVE TË VLERËSIMIT

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsyetimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy treguesve, njohuritë ligjore dhe arsyetimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1-A Njohuritë ligjore.

1-A-a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale, lidhur me këtë tregues, konkludohet se : “...Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ai identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Ka njohuri për rëndësinë e natyrës së mosmarrëveshjes lidhur me zgjidhjen e çështjes (shih dokumentet 1, 2, e 3 dhe dosjen nr. 1, 2, 3. Ka njohuri në fushat civile tregtare, identifikon ligjin e posaçëm që duhet zbatuar dhe e interpreton drejtë atë, duke prishur vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe kthyer për rigjykim, duke caktuar detyra konkrete për zgjidhje (shih dosjen nr. 1). Ka njohuri në fushën civile familjare, duke vlerësuar drejt rrethanat e çështjes (shih dosjen 3). Në çështjet penale i kushton rëndësi zbatimit të procedurës penale në fazën e hetimit paraprak (shih dosjen nr. 4). Gjithashtu, ai analizon kushtet ligjore për caktimin e një masë sigurimi (shih dosja 5)...”.

Nga përmbajtja e vendimeve përfundimtare, evidentohet aftësi shumë e mirë e gjyqtarit për të përcaktuar në mënyrë të thjeshtë dhe të qartë faktet e çështjes të cilat kanë rezultuar të provuara nga prova e shqyrtuara në gjykim në shkallë të parë, apo edhe gjatë gjykimit në apel, në rastet kur është vendosur riçelje e shqyrtimit gjyqësor. Gjyqtari paraqet dhe analizon rrethanat e faktit në bazë të një rendi

kronologjik duke e bërë të qartë dhe të kuptueshëm. Vëmendje të veçantë gjyqtari i kushton përcaktimit të fakteve në rastet kur gjykata ka vendosur kthimin e çështjes për rigjykim apo kur ka bërë cilësim të fakteve ndryshe nga shkalla e parë.

Gjyqtari harton vendimet me tekst unik, ku në shumicën e vendimeve fillimisht paraqiten rrethanat e çështjes në mënyrë të përmbledhur, siç janë konstatuar gjatë gjykimit, duke i ndërthurur me provat shkresore të marra gjatë gjykimit në shkallë të parë. Karakteristikë në të gjitha vendimet e gjyqtarit, pavarësisht natyrës së gjykimit (civile themeli, kërkesë civile, penale themeli apo kërkesë penale), është se rrethanat e faktit, parashtrihen në pjesën e parë të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimit, duke i integruar me provat e administruara gjatë gjykimit në shkallë të parë, ose me provat e administruara gjatë gjykimit në apel (shih vendimin nr. 3).

Nga përmbajtja e vendimeve përfundimtare, evidentohet aftësi shumë e mirë e gjyqtarit për të përcaktuar qartë *natyrën e marrëdhënies juridike*, për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja civile apo penale. Karakteristikë e vendimeve të gjyqtarit, është se natyra juridike e çështjes nuk identifikohet gjithmonë në mënyrë eksplicite, por gjithësesi edhe në këto raste ajo del e qartë nëpërmjet identifikimit të elementëve dhe kriterëve ligjore të mosmarrëveshjes. Në përcaktimin e saktë të natyrës së çështjes, gjyqtari identifikon dhe citon ligjin e zbatueshëm.

Një karakteristikë e vendimeve të tij është se arsyetimi i gjykatës nuk është e ndarë më vete, por i integruar në paraqitjen e ankimit të palës dhe provave në mbështetje të fakteve që kanë rezultuar të provuara gjatë gjykimit në shkallë të parë.

Nga vëzhgimi i procesverbaleve të seancave gjyqësore, evidentohet njohje dhe zbatim i ligjit si dhe dispozitave procedurale të referuara në mbështetje të vendimeve të ndërmjetme, gjatë zhvillimit të seancave dhe në përfundim të tyre. Në aspektin procedural, në 11 dosjet e vëzhguara, rezulton se përdoren referenca të sakta të dispozitave lidhur me kryerjen e veprimeve procedurale.

Ne vendimet gjyqësore të vëzhguara, konstatohet një rast ku gjyqtari ka evidentuar dhe analizuar një rast të *konfliktit të normave ligjore*, e konkretisht në vendimin civil nr. 573/2015, në lidhje me zbatimin e neneve 146, 153 dhe 155 të Kodit të Punës. Në këtë rast gjyqtari ka analizuar dhe ka dhënë përgjigje pretendimeve të palëve duke referuar edhe në vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë, nr. 19/2017.

Në tërësi, referuar të dhënave që evidentohen nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, vlerësohet se gjyqtari ka aftësi shumë të lartë për identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve dhe më pas të natyrës së çështjes, identifikimit të normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim mbi secilin fakt, citimin dhe analizën e normave respektive, identifikimin dhe analizën në rastin kur ka konflikt të normave.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

1-A-b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale, lidhur me këtë tregues, konkludohet se :
“...Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Parimet e përgjithshme të teorisë së të drejtës, ka raste që janë përdorur nga gjykata. Në rastin e dosjes nr. 1, gjyqtari ka përdorur parimin e konkurrencës së ndershme mes shoqërive tregtrare, duke i vënë rëndësi këtij parimi...Në dosjen 5, gjyqtari interpreton dhe parimin e gjykimit të drejtëpërdrejtë, duke sygjeruar prokurorin se rasti që po shqyrtonte mund të ishte proceduar me gjykim të drejtëpërdrejtë. Ai përdor drejtë parimin se konkluzionet e gjykatës më të lartë, janë detyruese për gjykatat më të ulta (shih dokumentin 3), ku gjykata ka riçelur hetimin gjyqësor, ka caktuar ekspert dhe e ka gjykuar çështjen në fakt. Në disa raste, në funksion të zbatimit të ligjit, subjekti përdor referenca nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë (shih dokumentin nr. 2) dhe nga akte të tjera ligjore (shih dokumentin 3, dosjen nr.1)...”

Në vendimet përfundimtare të gjyqtarit identifikohet norma ligjore dhe citohet, duke e shoqëruar me interpretimin dhe aplikimin e saj mbi faktet e çështjes në shqyrtim. Përveç citimit gjyqtari, kur është e nevojshme, bën një analizë ligjore dhe interpretim të kuptimit të dispozitave të caktuara të ligjit procedural dhe material që gjejnë zbatim mbi rastin konkret.

Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm, gjyqtari në disa prej vendimeve përfundimtare të tij, për shkak dhe të natyrës së çështjes, nuk bën një interpretim të normave të ligjit, por i citon ato në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete dhe në shërbim të analizës së fakteve, duke sjellë si rrjedhojë llogjike konkluzionin e arritur në lidhje me zbatimin e saj. Ndërkohë në shumicën e rasteve, normat ligjore shoqërohen me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e provuara dhe natyrën e marrëdhënies juridike, e konkretisht nga vendimet e vëzhguara evidentohet se;

a) analizon dhe interpreton nenin 1143 të Kodit Civil në lidhje me situatat kur siguruari shkarkohet nga përgjegjësia për të paguar dëmshpërblimin në rastin e sigurimit, duke e ndërthurur dhe analizuar zbatimin e këtyre kushteve më faktet e pretenduara dhe ato të provuara, ose jo, gjatë gjykimit në shkallë të parë (vendimi 213/2014),

b) interpreton nenet 143, 141 dhe 144 të Kodit të Punës dhe dallimin midis situatës së parashikuar nga neni 146 nga ai i neni 153, interpreton elementët dallues mes këtyre dy situatave, sic janë barra e provës, afati i ngritjes së padisë dhe menjëhershmeria e zgjidhjes së kontratës, duke cituar dhe interpretuar dispozitat përkatëse (vendimi nr. 573/2015), interpreton nenin 149 dhe 151/2 të Kodit të Punës duke referuar edhe te vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 5/2012, (vendimi nr. 1084/2015),

d) interpreton institutin e parashkrimit fitues pa titull dhe historikun e parashikimeve ligjore në kohë të ndryshme (vendimi 366 /2016) dhe referon orientimin e bërë nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë,

e) interpreton ligjin 7582/1992 “Për ndërmarrjet shtetërore” dhe VKM-të nr. 840/2004, 631/2006, 54/2014 (vendimi 1750/2016),

f) citon dhe interpreton ligjin 49/2012 dhe vendimin unifikues nr. 3/2013 të Gjykatës së Lartë në lidhje me kompetencën lëndore,

g) interpreton dispozita të ligjit “Për shoqëritë tregtare” e konkretisht nenet 102, 86, 87 , 230 (vendimi 3231/2014),

gj) interpreton nenin 252 dhe 228 të K.Pr.Penale në kërkesën penale për vleftësim arresti dhe caktim mase sigurie, nenin 28 dhe 29 të K.Pr.Penale në lidhje me kompetencën tokësore dhe nenin 291 të K.Pr.Penale, në lidhje me mosfillimin e procedimit penal, në kërkesën penale për kundërshtim të vendimit të prokurorit.

Në lidhje me interpretimin e dispozitave procedurale, përgjithësisht, evidentohet se gjyqtari, citon dhe kur është rasti interpreton dispozitat me natyrë procedurale. Në një rast (vendimi nr. 2013/2014) analizon dhe interpreton fuqinë provuese dhe mungesën e cilësimit si provë, të akteve të marra në shqyrtim nga gjykimi në shkallë të parë, analizon fuqinë provuese në një gjykim civil të vendimit penal të formës sipas nenit 70 të K.Pr.Penale.

Në lidhje me aftësinë e gjyqtarit për të përdorur jurisprudencën relevante, në shumicën e vendimeve të analizuara, rezulton se gjyqtari ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante të Gjykatës së Lartë, në mbështetje të argumenteve, interpretimit dhe zbatimit të ligjit në rastin konkret.

*Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, në shumicën e vendimeve të analizuara, rezulton se gjyqtari përmend dhe zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës, gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes. Evidentohet se gjyqtari njih dhe zbaton parimet procedurale gjatë gjykimit dhe parimet e së drejtës materiale të cilat i shërbejnë dhe i vijnë në ndihmë interpretimit të ligjit dhe zgjidhjes së çështjes në themel. Përmend parimin e përcaktuar në nenin 12 të K.Pr.Civile (vendimi 213/2014) që ka të bëjë me *barrën e provës* duke evidentuar zbatimin e gabuar të këtij parimi nga gjykata e shkallës së parë, parimin e përcaktuar në nenin 16 të K.Pr.Civile, sipas të cilit *gjykata është ajo që bën cilësimin e saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen pa u lidhur me përcaktimin që bëjnë palët*, (vendimi nr.366/2016), parimi i konkurrencës (vendimi 3231/2014).*

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, vlerësohet se gjyqtari ka aftësi shumë të lartë për të interpretuar ligjin në funksion të zgjidhjes së çështjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e Lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

I-B Arsyetimi ligjor

I-B-a Qartësia, konçiziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale, lidhur me këtë tregues, konkludohet se :“...Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej tij, janë të qarta dhe të kuptueshme. Në çdo rast respekton rregullat e drejtshkrimit, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe përdor rregullisht karakteret e gjuhës shqipe, me përjashtim të gërmës ë...”

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se vendimet e gjyqtarit janë në çdo rast të thjeshta, të lexueshme dhe të kuptueshme edhe. Në veprimet për drejtimin e seancave gjyqësore dhe vendimet përfundimtare përdoret gjuhë e thjeshtë, e qartë, e kuptueshme dhe e drejtpërdrejtë. Përdor fjalë të thjeshta dhe të kuptueshme në mënyrë që të kuptohet jo vetëm nga njohësit e ligjit, por edhe nga lexuesi i zakonshëm.

Evidentohet në të gjitha aktet e analizuara respektimi i rregullave gramatikore dhe të sintaksës, por mungon përdorimi i të gjitha shkronjave të gjuhës shqipe (nuk përdoret shkronja ë). Në arsyetimin e vendimeve evidentohet përdorimi i fjalive me gjatësi mesatare, të ndërthurura thjeshtë, lehtësisht të kuptueshme. Fjalitë dhe paragrafët e arsyetimit të vendimit janë në rrjedhë logjike me njëra tjetrën. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë konfuzion në lidhje me kuptimin e tyre apo të kontekstit në të cilin përdoren. Përdor gjuhën teknike në mënyrë korrekte, në rastet kur është e pashmangshme përdorimi i saj.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

I-B-b Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale, lidhur me këtë tregues, konkludohet se :“...Struktura e vendimeve të tij është e qëndrueshme e mirëorganizuar dhe e standardizuar. Ajo përmban elementët e kërkuar nga legjislacioni procedural, civil e penal. Subjekti i rivlerësimit mban të njëjtin stil në hartimin e akteve dhe organizimi strukturor i vendimeve paraqitet në nivel të kënaqshëm...”

Në aspektin strukturor, vendimet kryesisht kanë ndjekur një strukturë të mirë përcaktuar duke evidentuar qartë tri pjesët përbërëse të vendimit (pjesa hyrëse, arsyetimi, pjesa urdhëruese).

Pjesa *hyrëse* e të gjitha vendimeve përmban të gjithë elementët e nevojshëm në lidhje me përcaktimin e gjykatës, përbërjen e trupit gjykues, kohën e zhvillimit të gjykimit, të dhëna të plota të palëve dhe përfaqësuesve të tyre, objekti i shqyrtimit, disponimi i Gjykatës së Shkallës së Parë, si dhe kërkimet/shkaqet e ankimit të subjekteve në gjykimin në Apel. Në pjesën *përshkruese-arsyetuese*, ndiqet një strukturë e organizimit të vendimit, e cila fillon me shpjegimin e relatorit në lidhje me vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke e konsideruar ose jo rrjedhim të një procesi gjyqësor të zhvilluar në respektim të dispozitave procedurale civile/penale dhe i analizës së drejtë ose jo, të provave marrë në tërësinë e tyre. Në vijim, gjyqtari ndalet në trajtimin e fakteve të rezultuara në gjykimin në shkallë të parë, në mënyrë kronologjike, të vërtetuara nga provat e administruara në gjykimin, duke i dhënë përgjigje dhe pretendimeve në ankimin e paraqitur nga pala/palët. Duke vijuar, me konkluzionin e gjyqtarit në lidhje me bazueshmërinë ose jo të kërkimeve dhe parashtrimin e argumenteve lidhur me konkluzionin e arritur. Në pjesën *e dispozitivit*, gjen pasqyrim në mënyrë të plotë, baza ligjore, disponimi i gjykatës dhe data e shpalljes së vendimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

I-B-c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale, lidhur me këtë tregues, konkludohet se :“...Përmbajta e vendimit përfundimtar është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimeve ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari..Niveli i arsyetimit të vendimit respekton standartin e procesit të rregullt ligjor..”

Nga vëzhgimi i vendimeve gjyqësore, evidentohet aftësi shumë e mirë e gjyqtarit për të arsyetuar dhe analizuar në mënyrë shteruese të gjitha shkaqet e ankimit dhe pretendimet e palëve, duke analizuar për secilën prej tyre dispozitat përkatëse materiale të ligjit të zbatueshëm, në përputhje me rrethanat e faktit

dhe provat e marra në shqyrtim. Gjyqtari nëpërmjet një argumentimi llogjik, të thjeshtë dhe të kuptueshëm, identifikon marrëdhënien shkak – pasojë, analizon konceptet, institutet dhe dispozitat që zbatohen në rastin konkret. Ai evidenton në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, thelbin e çështjes që shqyrtohet, duke e bazuar më pas në analizën e koncepteve ligjore në funksion të zgjidhjes që i ka dhënë gjykata.

Gjithashtu, në çdo rast, gjyqtari evidenton në mënyrë të qartë normën ligjore të zbatueshme, duke bërë analizën për mënyrën e zbatimit të saj. Dispozitat ligjore që gjejnë zbatim në çështjet konkrete, jo vetëm referohen ose citohen kur është e nevojshme, por edhe analizohen dhe interpretohen në raport me faktet e çështjes apo me kërkimet e palëve në gjykim. Në lidhje me analizën dhe argumentimin ligjor të pretendimeve të palëve në ankim, evidentohet se ato analizohen të integruara në lidhje me normat konkrete të ligjit dhe rrethanat e faktit mbi të cilat ato zbatohen.

Në të gjitha vendimet, citohen dispozitat ligjore të zbatueshme dhe jepen argumentet përse ato janë të zbatueshme në çështjen konkrete. Kur është rasti, gjyqtari i plotëson argumentet e tij me referenca tek parimet e përgjithshme të së drejtës si dhe në jurisprudencën unifikuese të Gjykatës së Lartë. Të gjitha dispoizimet e gjykatës janë të lidhura qartësisht llogjikshëm me pjesën arsyetuese.

Në tërësi, në lidhje me këtë aspekt, arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë, merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve ndërgjyqëse, duke respektuar në çdo rast standardet e procesit të rregullt ligjor.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2. A Aftësia e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë.

2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara në këtë proces, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues është bërë duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësimin dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari.

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, lidhur me këtë tregues, konkludohet se : “Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short për gjyqtarin {...}, rezultoi se nga dita e marrjes së akteve me short gjer në dhënien e vendimit ka qenë e ndryshme për çdo çështje. Kohëzgjatja më e shkrutër ka qenë 7 ditë (shih dosjen nr. 5), ndërsa kohëzgjatja më e lartë ka qenë 11 muaj e 5 ditë (shih dosjen nr. 3). Në rastet e tjera gjykimet kanë zgjatur 10 muaj e 26 ditë, 10 muaj dhe 19 ditë, 3 muaj dhe 3 ditë. Sipas vendimit të KLD-së nr. 261/2, datë 14.04.2020 “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve”, Aneksi 1, pika 5 “Standardi kohor”, pikës 5, shkronjat “g”, “h” dhe “j”, rezulton se vetëm një çështje është përfunduar brenda afateve të përcaktuara në sistemin e vlerësimit, (shih dosjen 5). Në katër rastet e tjera konstatohet se është tejkalar afati standard i përcaktuar për gjykimet në shkallë të dytë sipas atij vendimi, por ky tejkalim ka një shkak të arsyeshem. Në rastin e çështjeve të paraqitura, dosjet 1, 2, 3, 4, tejkalimi i afatit të gjykimit, nuk është përgjegjësi e gjyqtarit, pasi në të gjitha rastet ai e ka përfunduar gjykimin me një seancë gjyqësore. Vonesat kanë ardhur për shkak të përcaktimit të seancës së parë të gjykimit, për një periudhë që i tejkalon afatet e gjykimit. Seanca e parë gjyqësore është caktuar nga kryetari i gjykatës, sipas nenit 460/2 të K.Pr.Civile, për çështjet civile dhe sipas nenit 426/1 të K.P.Penale, për çështjet penale. Prandaj nuk ka tejkalim të afatit nga ana e gjyqtarit”. Në 3 dokumentet e paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit, është bërë e mundur përcaktimi i afatit të gjykimit, nga të dhënat e vetë vendimit, data e vendimit dhe data e regjistrimit të çështjes, është marrë nga tabelat statistikore, pasi nuk është përsqyruar në vendimin gjyqësor. Për këto vendime, koha e gjykimeve ka qenë 6 muaj e 25 ditë (shih dokumentin nr. 1), 10 muaj dhe 10 ditë (shih dokumentin nr. 2) dhe 12 muaj e 5 ditë (shih dokumentin nr.3). Kjo e dhënë nuk tregon saktësisht datën e marrjes së akteve me short nga gjyqtari. Gjithashtu, nuk ka të dhëna se kur është caktuar seanca e parë e gjykimit nga kryetari i gjykatës, me qëllim që të përcaktohet saktë afati i gjykimit, për të cilin ka përgjegjësi gjyqtari”.

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari.

Në KPrP nuk parashikohet afat ligjor për gjykimin e çështjeve penale të themelit. Po kështu edhe për çështjet civile në përgjithësi nuk parashikohet afat ligjor për përfundimin e tyre.

Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari, referuar kategorisë së çështjeve, rezulton se vetëm për 1 dosje të çështjeve të përzgjedhura me short, parashikohen afate ligjore gjykimi. Konkretisht për dosjen nr. 5, afati ligjor i shqyrtimit të çështjes përcaktohet në nenin 249/5 të K.Pr.Penale, ku kërkesa është shqyrtuar nga ana e gjyqtarit brenda këtij afati (brenda 7 ditëve nga marrja në dorëzim e akteve).

Për pasojë, pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, duke iu referuar çështjes të analizuar më sipër, në të cilën parashikohet afat ligjor për përfundimin e saj, vlerësohet se aftësia e gjyqtarit në lidhje me këtë tregues, pikëzohet në nivelin maksimal.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në Raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, është i njëjti konkluzion i cituar në treguesin e mësipërm, pasi analiza e kohëzgjatjes së gjykimit për çështjet me afat ligjor dhe standard minimal kohor, është bërë së bashku.

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar vetëm 11 çështjeve të përzgjedhura me short, pasi 3 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari, nuk kanë informacion në lidhje me datën e

nxjerrjes së çështjes në gjykim. Për 10 çështjet e përzgjedhura me short rezulton se gjykimi ka përfunduar brenda standardit minimal kohor sipas vendimit nr.261/2 të ish KLD-së¹.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, nga 10 çështjet për të cilat zbatohen standardet minimale kohore, të gjitha çështjet kanë përfunduar brenda këtij afati të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të ish KLD-së. Kjo llogaritje bëhet duke u nisur nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim. Nga burimet e vlerësimit, për të gjitha çështjet e mësipërme, nuk ka informacion për datën e nxjerrjes së çështjes për gjykim, ku si datë e tillë konsiderohet data e caktimit të seancës gjyqësore nga ana Kryetarit të Gjykatës (për çështjet civile) dhe nga ana e gjyqtarit (për çështjet penale). Para ndryshimeve të K.Pr.Civile, me Ligjin 38/2017, nxjerrja e çështjeve civile për gjykim bëhej nga Kryetari i Gjykatës, i cili urdhëronte nxjerrjen e çështjeve për gjykim nëpërmjet afishimit të shpalljeve 3 javë para datës së seancës gjyqësore (neni 460 i K.Pr.Civile para ndryshimeve). Në këtë situatë, nëse do të llogarisnim përfshirjen e këtij afati 3/javor, në kohëzgjatjen e gjyqimit të çështjeve si më lart, përsëri do të arrinim në të njëjtin konkluzion në lidhje me respektimin e standardit minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Në raportin analitik të rivlerësimit, nuk ka të dhëna apo konkluzione lidhur me këtë tregues.

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjyqimit për secilën nga kategoritë e çështjeve që trajtohen në gjykata e Apelit në periudhën e vlerësimit.

Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues, do të bëhet duke iu referuar 10 çështjeve të përzgjedhura me short për të cilat zbatohet standardi minimal kohor dhe jo afati ligjor i gjyqimit², ndërsa për 3 vendimet

¹ Në pikën 5 të Aneksit g dhe h të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: “ *Standardi kohor i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari të gjyqimeve brenda një afati kohor maksimal nga data e caktimit të gjyqtarit të çështjes si me poshtë: a. Gjykimet penale në gjykatën e Apelit jo më tej se 2 muaj kur procedohet për kundërvajtje penale, jo më tej se 6 muaj kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në 10 vjet burgim dhe jo më tej se 9 muaj kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se 10 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.” Gjykimet civile në Gjykatën e Apelit jo më tej se 6 muaj”*

gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtari, nuk ka informacion në lidhje me datën e nxjerrjes së çështjes në gjykim.

Duke krahasuar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështje, në raport me standardin minimal kohor për cdo kategori (*8 çështjet e marra në analizë janë çështje civile, 1 çështje vendime penale themeli krime dhe 1 çështje penale - administrative*), rezulton se:

- (i) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 8 (tetë) çështjet në kategorinë e çështjeve “civile themeli” (duke prezumuar datën e seancës së parë gjyqësore, si datë të nxjerrjes së çështjes në gjykim, në kushtet kur në dosjet gjyqësore nuk ka informacion në lidhje me datën e nxjerrjes së çështjes për gjykim) rezulton të jetë 2.6 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor prej 6 (gjashtë) muajsh për gjykimin e çështjeve civile të themelit në Gjykatën e Apelit.
- (ii) Kohëzgjatja e gjykimit për 1 (një) çështje në kategorinë e çështjeve “penale administrative”, rezulton të jetë në të njëjtën ditë me datën e zhvillimit të seancës gjyqësore (duke prezumuar datën e seancës së parë gjyqësore, si datë të nxjerrjes së çështjes në gjykim, në kushtet kur në dosjet gjyqësore nuk ka informacion në lidhje me datën e nxjerrjes së çështjes për gjykim), pra më e shkurtër se standardi minimal kohor prej 2 (dy) muajsh për gjykimin e çështjeve penale-administrative në Gjykatën e Apelit.
- (iii) Kohëzgjatja e gjykimit për 1 (një) çështje në kategorinë e çështjeve “penale themeli krime”, rezulton të jetë 1 muaj e 12 ditë, (duke prezumuar datën e seancës së parë gjyqësore, si datë të nxjerrjes së çështjes në gjykim, në kushtet kur në dosjet gjyqësore nuk ka informacion në lidhje me datën e nxjerrjes së çështjes për gjykim), pra më e shkurtër se standardi minimal kohor prej 6 (gjashtë) muajsh për gjykimin e çështjeve penale-administrative në Gjykatën e Apelit.

Pra, kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara, është më e shkurtër se standardi minimal kohor për të gjitha çështjet e kësaj kategorie.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “ Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

² Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, parashikohet se :” *Në numrin total të çështjeve të gjykuara nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi.*”.

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “*Subjekti ka deklaruar se për periudhën 2014-2016, i janë caktuar për gjykim gjithësej 1134 çështje, ka përfunduar si relator 1072 çështje dhe ka mb{...} nga vitit 2016, 8 çështje. Këto të dhëna i përkasin viteve të plota kalendarike 2014, 2015 dhe 2016 (rezulton se çështjet e mb{...}a, nuk përputhen me shifrat e raportuara). Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna, është 94.5%”.*

Nga të dhënat statistikore të administruara në dosje, për periudhën e vlerësimit, rezulton se: Gjyqtari {...}, gjatë kësaj periudhe, sipas të dhënave statistikore, ka gjykuar gjithësej 940 çështje, prej të cilave; penale 257, civile të përgjithshme 675, familjare 8.

Duke qenë se ka mungesë të dhënash në tabelat me të dhëna statistikore për çështjet e caktuara gjatë periudhës së vlerësimit si dhe mospërputhje të numrit të çështjeve të përfunduara në bazë të të dhënave statistikore me të dhënat e pasqyruara në Raportin e analizimit të aftësive profesionale, mbetet e pamundur përlllogaritja e rendimentit sipas të dhënave statistikore që administrohen në dosje. Për pasojë, merret i mirëqene rendimenti 94.5 % i përcaktuar në faqen 31 të Raportit, faqe 748 i dosjes së rivlerësimit, kjo në fazën e përgatitjes së projektraportit të vlerësimit.

Ndërkohë, sipas vërtetimit nr. 2662 prot, dt 24.05.2021, të dhënë nga Gjykata e Apelit Tiranë, e paraqitur nga ana e gjyqtarit me kundërshtimet e tij për këtë tregues, rezulton se ky rendiment është mbi 99 % . Duke u bazuar në këto të dhëna, për këtë tregues gjyqtari vlerësohet maksimalisht.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “ Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);
- Informacioni i përcjellë nga gjykata lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar.

Në lidhje me këtë tregues, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky është treguesi mesatar i kohës së arsytimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit deri në datën e depozitimit në sekretari të vendimit të arsyetuar.

Në vlerësimin për periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar të dhënave që ofrojnë tabelat me të dhëna statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit, nuk jepen të dhëna për kohën e arsytimit të të

gjitha vendimeve gjyqësore, sipas kategorive. Për këtë arsye, ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim.

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale, lidhur me kohën mesatare të arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, konkludohet se “...si datë e arsytimit të vendimit, është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e dhëna e vetme objektive për këtë fakt. Lidhur me kohën mesatare të arsytimit të vendimeve gjyqësore, nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara, rezultoi se gjyqtari {...} i kushton rëndësi të veçantë arsytimit në kohë të shpejtë të vendimeve. Konkretisht, arsytimi i vendimeve është kryer për 3 ditë nga shpallja (shih dosjet nr.1), për 4 ditë nga shpallja (shih dosjen nr. 2), për 5 ditë nga shpallja (shih dosjen nr. 3, nr. 4) dhe për 7 ditë (shih dosjen nr. 5). Të gjitha vendimet janë arsyetuar brenda afatit, pasi nuk konstatohet në asnjë rast, të jetë tejkaluar afati i rekursit prej 30 ditësh”.

Në Kodin e Procedurës Civile dhe në Kodin e Procedurës Penale para ndryshimeve, nuk parashikoheshin afate procedurale për dorëzimin e vendimeve të arsyetuara. Konkretisht, në Kodin e Procedurës Civile para ndryshimeve të vitit 2017, nuk parashikohej afat procedural për dorëzimin e vendimeve, por ky afat nuk mund të ishte më i gjatë se afati për ushtrimin e të drejtës së rekursit, sipas parashikimeve të nenit 443/2 dhe nenit 476 të këtij kodi. Edhe në Kodin e Procedurës Penale para ndryshimeve, nuk parashikoheshin afate procedurale në dorëzimin e vendimeve të arsyetuara. Në praktikën gjyqësore, ndiqej e njëjta llogjikë si në Kodin e Procedurës Civile të sipërcituar, ku ky afat nuk mund të ishte më i gjatë se afati i ankimit 30 ditë sipas parashikimeve të nenit 435/1 të .Pr.Penale. Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

- Dosja që i përket vendimit me nr. 3231, datë 26.09.2014 është dorëzuar më datë 29.09.2014 (3 ditë);
- Dosja që i përket vendimit me nr. 1867, datë 23.09.2016 është dorëzuar më datë 27.09.2016 (4 ditë);
- Dosja që i përket vendimit me nr. 168, datë 23.01.2015 është dorëzuar më datë 28.01.2015 (5 ditë);
- Dosja që i përket vendimit me nr. 443, datë 18.03.2015 është dorëzuar më datë 23.03.2015 (5 ditë);
- Dosja që i përket vendimit me nr. 724, datë 04.07.2014 është dorëzuar më datë 11.07.2014 (7 ditë);

Sipas informacionit të dërguar nga Gjykata e Apelit Tiranë më datë 12.10.2020, lidhur me 6 dosjet e përzgjedhura me shortin e datës 09.10.2020, rezulton se:

- Dosja që i përket vendimit me nr. 704, datë 05.03.2014 është dorëzuar më datë 12.03.2014 (7 ditë);
- Dosja që i përket vendimit me nr. 24, datë 15.01.2014 është dorëzuar më datë 16.01.2014 (1 ditë);
- Dosja që i përket vendimit me nr. 1084, datë 08.05.2015 është dorëzuar më datë 12.05.2015 (4 ditë);
- Dosja që i përket vendimit me nr. 1750, datë 22.07.2016 është dorëzuar më datë 27.07.2016 (5 ditë);
- Dosja që i përket vendimit me nr. 56, datë 28.09.2016 është dorëzuar më datë 30.09.2016 (2 ditë);

- Dosja që i përket vendimit me nr. 1814, datë 28.10.2015 është dorëzuar më datë 02.11.2015 (4 ditë).

Duke iu referuar kategorive të çështjeve objekt shqyrtimi, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit për kategorinë civile themeli, për 8 dosje (dosja 1, 2, 3, 6, 7, 8, 9 dhe 10), është 3.8 ditë, për kategoritë penale krime, dorëzimi i vendimit është 4 ditë (dosja 11), për kategoritë penale administrative, koha mesatare e arsyetimit të vendimit për 2 dosje (dosja 4, 5) është 6 ditë. Referuar të dhënave, koha mesatare rezulton “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve ” dhe pikëzohet me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “ Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar në kuadër të rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “...Rezulton se pesë prej dosjeve të vëzhguara, kanë përfunduar të gjitha me një seancë të vetme (shih dosjet 1,2,3,4 dhe 5). Këto të dhëna tregojnë se janë vëzhguar gjithësej 5 seanca gjyqësore të zhvilluara, të cilat kanë qenë produktive dhe nuk ka asnjë rast shtyrje të seacës. Rezulton se nuk ka patur asnjë seancë të dështuar. Gjyqtari ka realizuar njoftimet në afat dhe ka dokumentuar shumë mirë kryerjen e veprimeve. Seancat janë zhvilluar në sistemin audio. Ky është tregues i respektimit të solemnitetit të gjykimit dhe të bërjes transparente të çdo veprimi që ndodh gjatë gjykimit. Seancat janë zhvilluar në salla duke dokumentuar rregullisht këtë veprim. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve është konstatuar në fillimin e seancës që i përket dosjes 2, seanca gjyqësore është çelur në orën e përcaktuar. Në 4 rastet e tjera, seancat kanë filluar me vonesë (shih dosjet nr. 1, 3, 4, 5)..Subjekti është i qartë për rolin e Gjykatës së Apelit dhe kryen veprimet e nevojshme procedurale për zgjidhjen e pretendimeve të paraqitura në ankimin e palëve, duke qenë i qartë në veprimet procedurale që realizon. Ndër 5 dosjet e vëzhguara rezulton se ato kanë përfunduar brenda një seance, që tregon se relatori e ka njohur çështjen dhe i është përmbajtur kërkesave të ligjit...”.

Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, të cilat i përkasin kategorive të çështjeve civile themeli, penale themeli dhe penale administrative, lidhur me numrin e seancave gjyqësore, evidentohet si më poshtë:

Dosja 1, çështja me nr. regjistri 5178/2466, datë regjistrimi 30.10.2013, nr. vendimi 3231, datë vendimi 26.09.2014. Është zhvilluar **1 seancë gjyqësore**, e cila ka qenë produktive.

Dosja 2, çështja me nr. Regjistri 4961/2371, datë regjistrimi 04.11.2015, nr. vendimi 1867, datë vendimi 23.09.2016. Është zhvilluar **1 seancë gjyqësore**, e cila ka qenë produktive.

Dosja 3, çështja me nr. regjistri 3571/202, datë regjistrimi 18.02.2014, nr. vendimi 168, datë vendimi 23.01.2015. Është zhvilluar **1 seancë gjyqësore**, e cila ka qenë produktive.

Dosja 4, çështja me nr. regjistri 2548/1359, datë regjistrimi 15.12.2014, nr. vendimi 443, datë vendimi 18.03.2015. Është zhvilluar **1 seancë gjyqësore**, e cila ka qenë produktive.

Dosja 5, çështja me nr. regjistri 723, datë regjistrimi 26.06.2014, nr. vendimi 724, datë vendimi 04.07.2014. Është zhvilluar **1 seancë gjyqësore**, e cila ka qenë produktive.

Dosja 6, çështja me nr. regjistri 2616/411, datë regjistrimi 18.02.2013, nr. vendimi 704, datë vendimi 05.03.2014. Është zhvilluar **1 seancë gjyqësore**, e cila ka qenë produktive.

Dosja 7, çështja me nr. regjistri 194/321, datë regjistrimi 18.02.2013, nr. vendimi 24, datë vendimi 15.01.2014, është zhvilluar **1 seancë gjyqësore**, e cila ka qenë produktive.

Dosja 8, çështja me nr. regjistri 4720/811, datë regjistrimi 19.05.2014, nr. vendimi 1084, datë vendimi 08.05.2015. Është zhvilluar **1 seancë gjyqësore**, e cila ka qenë produktive.

Dosja 9, çështja me nr. regjistri 4319/1739, datë regjistrimi 23.06.2015, nr. vendimi 1750, datë vendimi 22.07.2016. Janë zhvilluar **2 seanca gjyqësore**, 1 prej të cilave një seancë ka qenë joproduktive për shkak të mosformimit të trupit gjykues. Seancat gjyqësore janë rregjistruar me sistemin audio dhe po kështu janë dokumentuar rregullisht në procesverbal

Dosja 10, çështja me nr. regjistri 56, datë regjistrimi 31.08.2016, nr. vendimi 56, datë vendimi 26.09.2016. Janë zhvilluar **3 seanca gjyqësore**, 2 prej të cilave kanë qenë jo produktive, pasi janë shtyrë me kërkesë të palës së paditur, për tu njohur me dosjen dhe për arsye shëndetësore.

Dosja 11, çështja me nr. regjistri 1792, datë regjistrimi 17.02.2015, nr. vendimi 1814, datë vendimi 28.10.2015. Janë zhvilluar **2 seanca gjyqësore**, të cilat kanë qenë produktive.

Nga tërësia e të dhënave si më sipër, rezulton se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtari në çështjet e vëzhguara varion nga 1 deri në 3 seanca. Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar 11 çështjeve të vëzhguara, rezulton të jetë 1.4 dhe gjyqtari ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave jo produktive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar në kuadër të rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se : *“...Procesverbali gjyqësor dokumenton gjykatën, trupin gjykues, palët, objektin, kohën dhe vendin, si dhe veprimet që kryhen në seancë, konform kërkesave të K.Pr.C dhe K.Pr.P. Vendimet e ndërmjetme fiksohen në procesverbalin e seancës gjyqësore. Gjithashtu, tek 5 dosjet janë konstatuar edhe disa mangësi, që janë të njëjta, që tregojnë se bëhet fjalë edhe për metodologji pune. Relatimi i gjyqtarit për çështjen konkrete, bëhet në mënyrë verbale dhe përmbledhet me një frazë të përgjithshme në procesverbalin gjyqësor. Nuk dokumentohet shkaku i fillimit me vonesë të seancës gjyqësore”.*

Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, lidhur me kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, evidentohet si më poshtë:

Në 11 çështjet e përzgjedhura me short, 9 prej tyre i përkasin kategorive çështje civile dhe penale me palë kundërshtare dhe 2 çështje i përkasin kategorisë së kërkesave penale të hetimit paraprak. Në dosjet e vëzhguara, të kategorisë çështje civile, konstatohet se gjyqtari nuk ka nxjerrë vendim për caktimin e seancës gjyqësore si dhe caktimi i seancës së parë gjyqësore, pas caktimit të çështjes me short, është bërë mbi bazën e rregullave të gjykimit të çështjeve në Apel, konform nenit 460 të K.Pr.Civile³. Ndërsa në çështjet penale, nga ana e gjyqtarit, janë kryer veprimet paraprake të gjykimit, në përputhje me nenin 426 të K.Pr.Penale, ku ai ka vënë në lëvizje dosjen duke caktuar datën e zhvillimit të seancës gjyqësore dhe njoftimin e palëve. Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, mbajtur me regjistrim audio si dhe dokumentohen me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka kryer të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor, të cilat janë të dokumentuara. Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligji për gjykimin në apel (*neni 464 i K.Pr.Civile dhe neni 426/a i K.Pr.Penale*) kur është gjykuar si shkallë e dytë mbi bazë ankimi. Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, mbajtur me regjistrim audio. Seancat gjyqësore janë zhvilluar në mënyrë korrekte duke ndjekur ecurinë procedurale sipas dispozitave të K.Pr.C dhe duke pasqyruar veprimet e kryera; për verifikimin e paraqitjes së palëve dhe përfaqësuesve të tyre, shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë të palëve të cilët nuk janë prezent, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar (*si shkallë e dytë*), relatimin e çështjes nga relatori, dhënien e fjalës palëve mbi shkaqet e ankimit, shtyrjen e seancave gjyqësore duke pasqyruar shkaku në çdo rast si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (*njoftimin e palëve*), dhënien përfundimtare të fjalës palëve, tërheqjen e gjykatës për marrjen e vendimit dhe shpalljen e vendimit përfundimtar. Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore

³ .. Kryetari i gjykatës së apelit cakton relatorin e çështjes dhe ditën e gjykimit. Njoftimi për ditën dhe orën e gjykimit të çështjeve bëhet nga gjykata e apelit me shpallje pranë saj dhe në gjykatat përkatëse të shkallës së parë, jo më vonë se 10 ditë përpara shqyrtimit të çështjes.

përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes. Në dosje të vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur përgjithësisht me vonesë, dhe nuk është relatuar shkaku i fillimit të seancës me vonesë.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se nga ana e gjyqtarit janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, duke respektuar të gjitha standartet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit civil apo penal në seancat gjyqësore të vëzhguara.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 20 pikë.

2.C Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore.

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar në kuadër të rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se : “...Është konstatuar se aktet e hartuara nga gjykata janë të rregullta, të sakta dhe të plota..Dosjet janë të inventarizuara rregullisht”.

Nga vëzhgimi i dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes konstatohet se, aktet janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e dosjes ndjek kryesisht të njëjtën linjë në të 11 dosjet e vëzhguara duke grupuar aktet sipas kategorisë së tyre. Renditja e akteve në dosje, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe gjykata më e lartë. Dosjet paraqiten të rregullta nën aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se nga ana e gjyqtarit renditja e akteve të dosjes gjyqësore është në atë mënyrë që e bën dosjen lehtësisht të shfrytëzueshme.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar në kuadër të rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se : *“..Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, përgjithësisht nuk janë konstatuar mangësi në aftësitë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të...”*.

Nga vëzhgimi i dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes, rezulton se në dosje ndodhen të gjitha aktet e paraqitura nga palët, aktet e hartuara nga gjykata (procesverbalet e seancës gjyqësore, vendimet gjyqësore, procesverbali audio). Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete. Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet që dokumentacioni në dosje, është në përputhje me veprimet procedurale të kryera, nuk ka mungesa, dhe se është i duhuri.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3. A Etika në punë

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar Raportit për analizimin e aftësisë profesionale të gjyqtarit me nr. 744/1 prot, datë 08.04.2019 dhe kopjes së dosjes personale të gjyqtarit administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se;

“Për periudhën e vlerësimit, për gjyqtarin {...}, janë paraqitur 6 ankesa në Inspektoriatin e KLD-së (1 në vitin 2013, 3 në vitin 2014, 1 në vitin 2015 dhe 1 në vitin 2016). 4 ankesa (1 e vitit 2013, 1 e vitit 2014, 1 e vitit 2015 dhe 1 e vitit 2016), janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, me arsyetimin se pretendimet mund të zgjidhen përmes apelimit gjyqësor. 2 ankesat e tjera, janë verifikuar dhe rezultatet e tyre janë si vijon; 1 ankesë e vitit 2014, verifikuar për mosrespektim formal të ligjit, është arkivuar me arsyetimin se pretendimi është i pabazuar; 1 ankesë e vitit 2014, verifikuar mbi bazën e informacionit periodik, ardhur nga kryetari i gjykatës, lidhur me vendimet e cënuara, është vendosur t’i regjistrohet gjyqtarit, për efekt vlerësimi profesional dhe etik”.

Në lidhje me ankesën për të cilën referon raporti, në aktet e dosjes së rivlerësimit nuk rezulton të jenë administruar të dhënat për trajtimin e ankesës. Për këtë arsye, u kërkua nga arkiva e KLGJ-së informacion dhe dokumentacion lidhur me trajtimin e ankesës, si dhe është administruar kopje të relacionit të inspektoratit të KLD-së lidhur përfundimin e verifikimit përkatës, akte të cilat janë bërë pjesë e dosjes së vlerësimit të gjyqtarit. Nga përmbajtja e dokumentacionit për verifikimin dhe trajtimin e ankesës, ka rezultuar se në këtë ankesë janë trajtuar vendime të vitit 2010 dhe 2011 të cilat janë jashtë periudhës së vlerësimit. Gjithashtu këto vendime, *nuk* përbëjnë një tregues për efekt të vlerësimit të aftësive, në kuadër të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit, bazuar në Ligjin nr. 96/2016 dhe aktet nënligjore që plotësojnë Skemën e Vlerësimit, në lidhje me cënimin e vendimeve nga gjykatat më të larta në kuadër të shqyrtimit të ankimit të palëve.

Gjithashtu, sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim, dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

Referuar burimeve të vlerësimit, **nuk** evidentohet të ketë të dhëna që mund të tregojnë cënim të etikës apo përgjegjshmërisë në ushtrimin e funksionit, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim, mungesë vetëpërmbajtje, ndjeshmërie, vëmendje, apo praninë e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtarit, gjatë ushtrimit të funksionit.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e etikës së gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 35 pikë.

3. B Integriteti i gjyqtarit

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtarin {...} në periudhën e vlerësimit, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Lidhur me rezultatet e trajtimit të ankesave të nisur gjatë periudhës së vlerësimit (analizuar në treguesin më sipër), nuk rezulton asnjë e dhënë që të dëshmojë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtarit, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të integritetit si dhe **nuk** rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjelle që cenojnë nderin dhe dinjitetin e saj.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e integriteti të gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 40 pikë.

3. C Paanësia e gjyqtarit

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar në kuadër të rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se : “..Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk

është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit..”.

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të dorëzuara nga gjyqtari dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtari, në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve përkatëse të administruara në dosjet e gjykimit. Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese nga ana gjyqtarit.

Referuar burimeve të vlerësimit, **nuk** rezulton që gjyqtari të ketë përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejte ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit si dhe në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar në kuadër të rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se : “..Për vetë gjyqtarin {...} në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve..”.

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtarit, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore.

Nga burimet e tjera (burimet arkivore të KLD/KLGJ) si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit në periudhën e vlerësimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit ne drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A Aftësia e komunikimit.

4.A. a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar në kuadër të rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se : *“Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor në format letër, është konstatuar se komunikimi ka qenë i qartë dhe i rregullt. Gjuha e përdorur në seancë gjyqësore dhe në akte tek 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë”*.

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short (kryesisht procesverbaleve të seancave dhe vendimeve gjyqësore) rezulton se gjyqtari gjatë komunikimit me palët është i qartë, transparent dhe i kuptueshëm. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarit për të qartësuar pretendimet e palëve apo orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi i tij është i drejtpërdrejtë dhe konkret në lidhje me çështjet për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre. Gjithashtu, evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në

arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë.

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka komunikim të qartë dhe transparent, me pjesëmarrësit në gjykim si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit në këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Referuar burimeve të vlerësimit, **nuk** rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve, apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, gjyqtari në këtë tregues, vlerësohet në nivelin “Shumë i lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B Aftësia për të bashkëpunuar

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, prezumohet se ai ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësitë e gjyqtarit në këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, prezumohet se ai ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit në këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

4.C Gatishmëria e gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Referuar vërtetimit të Shkollës së Magjistraturës me nr. 853 prot, datë 21.10.2016, rezulton se gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit ka qënë pjesëmarrës në aktivitetet trajnuese si më poshtë:

1. Tema “Etika gjyqësore”, trajnim i zhvilluar në datë 17 prill 2014.
2. Tema “Dëmi jashtëkontraktor dhe përgjegjësitë që rrjedhin prej tij”, trajnim i zhvilluar në datë 2 shkurt 2015.
3. Tema “Dëmet, shpërblimet dhe kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit (Efektet e ligjit nr. 10076/12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar dhe të kateve nënligjore në fuqi.; ndikimi i vendimit unifikues nr. 14/12.09.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gj.L, në praktikën gjyqësore.)”, trajnim i zhvilluar në datë 30 mars 2015.
4. Tema “Konventat e Hagës në fushën e të drejtës ndërkombëtare private dhe roli i sistemit të drejtësisë”, trajnim i zhvilluar në datë 8 qershor 2015.
5. Tema “Zbatimi i standarteve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut për nenin 10 të KEDNJ-së, trajnim i zhvilluar në datë 21-22 korrik 2015.

6. Tema “Shkeljet e Pronësisë Intelektuale në Internet si dhe veprat në vënde publike. Kazuse konkrete nga praktika shqiptare dhe ajo ndërkombëtare.”, trajnim i zhvilluar në datë 28 janar 2016.
7. Tema “Nënshkrimi elektronik. Garancitë proceduriale dhe ligji mbi nënshkrimin elektronik”, trajnim i zhvilluar në datë 7 prill 2016.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka marrë pjesë në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, në cilësinë e pjesëmarrësit në 7 aktivitete trajnuese, në 8 ditë, kohëzgjatje e cila është jashtë kufijve 15 deri në 120 ditë në gjithë periudhën tri vjeçare. Ndërkohë Ligji nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në fuqi në periudhën e vlerësimit, nuk kishte parashikim lidhur me detyrimin e gjyqtarit për të marrë pjesë në aktivitete trajnuese, por ky detyrim përcaktohej në nenin 23 të ligjit nr. 8316/1999 “Për Shkollën e Magjistraturës”, i ndryshuar, sipas të cilit; *gjyqtarët dhe prokurorët e gjykatave e të prokurorive të shkallës së parë dhe të gjykatave të apeleve i nënshtrohen formimit vazhdues. Periudha e formimit vazhdues nuk duhet të kalojë më shumë se 20 ditë në vit dhe jo më shumë se 60 ditë gjatë pesë vjetëve.*

Referuar rregullimit ligjor të kohës, i cili parashikonte detyrimin për të marrë pjesë në aktivitete trajnuese dhe përcaktonte *vetëm kufirin maksimal* të kësaj pjesëmarrje, rezulton se gjyqtari i ka përmbushur ato, e për këtë arsye, pikëzimi për këtë tregues, është maksimal.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues, gjyqtari vlerësohet me 20 pikë.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se për periudhën e vlerësimit, për gjyqtarin nuk evidentohen të dhëna në lidhje me këtë tregues. Duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se, *për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari.*

Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues gjyqtari, vlerësohet me 3 pikë.

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se për periudhën e vlerësimit, nuk evidentoheshin të dhëna në lidhje me këtë tregues. Duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se, *për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari.*

Në lidhje me këtë tregues, gjyqtari në kundërshtimet e tij parashtroi faktin se ; *sa i takon veprimtarisë sime ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë... mund të përmend që në periudhën e këtij vlerësimi, 2014 – 2015, Unioni i Gjyqtarëve, ku unë kam qënë fillimisht drejtues e më pas anëtar i bordit drejtues, ka organizuar disa projekte me ndihmën dhe financimin e USAID, si “Reforma Kushtetuese në Optikën e Gjyqtarëve”, ku janë zhvilluar takime në disa gjykata të vëndit, botimi i “Manualit për Gjykimin Civil”, “Manualit për Gjykimin Penal” dhe “Manuali i Etikës Gjyqësore”, si dhe seminari “Sfida dhe Zhvillime në Sektorin e Drejtësisë”, financuar nga Partners Albania for Change and Development. Sipas vërtetimit të datës 09.06.2021, dhënë nga zyra e Regjistrimit të OJF-ve, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, rezulton se; gjyqtari {...} është zgjedhur dhe ka qwnw Kryetar i shoqatës Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë, në periudhwn 2008- 2011 dhe ka qënë antari i Bordit Drejtues në periudhën 2008-2018.*

Ky angazhim nga Këshilli vlerësohet si pjesëmarrje në këto lloj veprimtarish, sipas Metodologjisë së Pikëzimit. Duke qenë se edhe periudha e këtij angazhimi, përfshihet gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtari vlerësohet maksimalisht dhe pikëzohet me 5 pikë.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues, gjyqtari vlerësohet me 5 pikë.

4.C.ç Publikimet ligjore akademike.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër si dhe formularit të deklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtarit, **nuk** rezulton që gjyqtari, gjatë periudhës së vlerësimit të ketë realizuar publikime ligjore akademike me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinës.

Angazhimi i gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues, gjyqtari vlerësohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
93	Shkëlqyeshëm

NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	93	Shkëlqyeshëm
Propozim për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	393	Shkëlqyeshëm